



# KOALICIONI PER NXITJEN E PJESMARRJES SE GRAVE, TE RINJVE DHE MINORITETEVE NE POLITIKE

Albanian Coalition for Promotion of Women, Youth and Minorities in Politics

Tiranë, 30.03.2007

## THIRRJE

### NJE GRUA PER PRESIDENTE TE SHQIPERISE

Koalicioni për Nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave dhe të Rinjve në Politikë, një nga grupimet kryesore të shoqërisë civile në Shqipëri, ka si qëllim të advokojë për një përfaqësim më të drejtë të grave, të rinjve dhe minoriteteve në Parlament, Qeverinë qendrore dhe lokale, në partitë dhe forumet politike, si dhe në vendimmarrje.

Koalicioni për Nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave dhe të Rinjve në Politikë po ndjek me interes diskutimet që po bëhen për zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës së Shqipërisë, zgjedhje që mendohet të bëhet në muajin Qershor 2007.

Duke patur parasysh se gratë dhe vajzat në Shqipëri kanë përfaqësimin politik më të ulët shoqëror në Shqipëri, ne mendojmë se ka ardhur koha që partitë politike të mendojnë seriozisht propozimin e një kandidateje grua për Presidente të Republikës.

**Me këtë rast ne i propozojmë të gjitha partive politike parlamentare dhe deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, që të marrin në konsideratë këtë propozim të Koalicionit, duke bërë të mundur që Shqipëria të ketë për herë të parë në historinë e saj një Grua për Presidente të Republikës.**

**Zgjedhja e një gruaje në krye të shtetit, jo vetëm që krijon një imazh të rëndësishëm përpara Bashkimit Europian dhe botës perëndimore, por ajo shërben si udhërfyes për sukses për të gjitha gratë dhe vajzat në Shqipëri. Nga ana tjetër kjo do të tregonte pjekurinë e demokracisë në vend dhe një ndarje të drejtë të pushtetit midis burrave dhe grave në Shqipëri.**

Gratë në Shqipëri përbëjnë më shumë se 50 për qind të popullsisë, ndërkohë që janë të përfaqësuara vetëm me 10 vende në Parlament, që përbën vetëm 7 për qind të deputetëve të Parlamentit të Shqipërisë, duke e renditur Shqipërinë të parafundit në Evropë për sa i përket përfaqësimit të grave në jetën politike të vendit. Ndërkaq që, në Zgjedhjet Lokale të këtij viti, prej 1073 kandidatëve të regjistruar për krejt Bashki dhe Komune, vetëm 33 kanë qenë gra ose vajza të reja, ose rreth 3 për qind e numrit të përgjithshëm të kandidatëve, që përbën një shifër tepër të vogël të kandidimit të grave dhe vajzave të reja në këto zgjedhje. Nga 369 kryetarët e bashkive, njësisive bashkiake dhe komunave të shpallura deri tani vetëm 10 janë gra.

Gra presidente ka pasur dhe ka në shumë vende të botës, si: Argjentinë, Finlandë, Filipine, Irlandë, Islandë, Izrael, Kili, Letoni, Liberi, Maltë, Nikargua, Zvicër etj.

Koalicioni beson se vënia e një gruaje si Presidente e Shqipërisë do ta zbuste pjesëmarrjen e ulët të grave në politikë, si dhe klimën e ashpër dhe mosbesuese që mbizotëron në politikën shqiptare.

Për më shumë info, kontaktoni:

---

Koalicioni per Nxitjen e Pjesnarrjes se Grave, te Rinjve dhe Minoriteteve ne Politike  
Adresa e zyrave: Pallatet e Shallvareve, Vila mbrapa Fushave te Tenisit, kati i 2-te, Tirane  
Adresa postare: Kutia Postare 1738, Tirana / Albania  
Tel/fax: 04 242264 E-mail: [crca@crca.org.al](mailto:crca@crca.org.al) [www.crca.org.al](http://www.crca.org.al)